

Neni 2

Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet për të gjithë punonjësit e IPK-së që angazhohen në aktivitete kërkimore-shkencore, në përputhje me planin e punës dhe objektivat institucionale;
2. Subvencionet sipas kësaj Rregulloreje mund të përdoren për:
 - 2.1. Botime dhe publikime në revista shkencore të indeksuara dhe të njohura sipas standardeve shkencore ndërkombëtare akademike;
 - 2.2. Pjesëmarrje dhe prezantim, individualisht apo në bashkëautorësi, në konferenca shkencore-kombëtare dhe ndërkombëtare, qoftë në mënyrë fizike apo online;
 - 2.3. Botime tjera shkencore jo monografi, individualisht apo në bashkëautorësi, si libra shkencor, përmbledhje dhe materiale të tjera shkencore;
 - 2.4. Realizimin e projekteve dhe aktiviteteve kërkimore-shkencore të cilat nuk mbulohen nga kategoritë tjera buxhetore të IPK-së;
 - 2.5. Aktivitete të tjera akademike dhe shkencore të aprovuara nga organet kompetente të IPK-së.

Neni 3

Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këto kuptime:
 - 1.1. “Subvencion” – mbështetje financiare e ndarë nga IPK për aktivitete kërkimore-shkencore;
 - 1.2. “Punonjës” – personi i punësuar në IPK sipas legjislacionit në fuqi;
 - 1.3. “Punë kërkimore-shkencore” – aktivitete nga plani i punës që lidhen me hulumtimin, publikimin, prezantimin dhe zhvillimin akademik dhe shkencor;
 - 1.4. “Publikim shkencor” – artikull, monografi, ose material tjetër akademik i botuar apo i pranuar për botim në revista apo shtëpi botuese shkencore ku punonjësit e IPK-së marrin pjesë si autorë, pavarësisht renditjes, pra jo vetëm si autor i parë apo korrespondent dhe të cilat nuk financohen nga kategoritë tjera buxhetore të IPK-së.
 - 1.5. “Konferencë shkencore” – organizim akademik ose profesional ku prezantohen punime shkencore;
 - 1.6. “Revistë shkencore” – revistë akademike e indeksuar ose e njohur sipas standardeve shkencore.

1.7 “Revistë e indeksuar” – revistë e përfshirë në databaza akademike dhe ndërkombëtare të njohura nga organet kompetente.

1.8. “Konflik interesi” – çdo situatë në të cilën interesi personal, profesional ose financiar mund të ndikojë në panashmërinë e vendimmarrjes.

Neni 4 **Parimet themelore**

1. Zbatimi i kësaj Rregulloreje bazohet në këto parime:

- 1.1.Ligjshmëria;
- 1.2.Transparenca dhe llogaridhënia;
- 1.3.Barazia dhe mosdiskriminimi;
- 1.4.Konkurrenca akademike;
- 1.5.Përgjegjshmëria financiare;
- 1.6.Integriteti akademik dhe etika kërkimore;
- 1.7.Objektiviteti dhe paanshmëria në vendimmarrje;
- 1.8.Shmangia e konfliktit të interesit.

KAPITULLI II **FORMAT E MBËSHTETJES FINANCIARE**

Neni 5 **Kategoritë e subvencionimit**

1. IPK përmes kësaj Rregullore subvencionon këto kategori:

- 1.1. Tarifat për publikim të artikujve shkencorë;
- 1.2. Shpenzimet për pjesëmarrje në konferenca shkencore jashtë vendit;
- 1.3. Shpenzimet e regjistrimit në konferenca shkencore jashtë vendit, virtuale ose me prezencë fizike;
- 1.4. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit jashtë vendit;
- 1.5. Shpenzimet për realizimin e projekteve kerkimore-shkencore;
- 1.6. Botimin e përmbledhjeve ose të materialeve të tjera shkencore;

1.7. Projekte dhe aktivitete të tjera kërkimore-shkencore të aprovuara nga menaxhmenti i IPK-së.

Neni 6 **Burimi i financimit**

1. Subvencionet financohen nga buxheti i IPK-së në kategorinë ekonomike “Subvencione dhe transfere”.
2. Shuma e subvencioneve përcaktohet sipas planifikimit buxhetor vjetor dhe mundësive financiare të IPK-së.
3. IPK synon shpërndarjen proporcionale të subvencioneve përgjatë vitit fiskal për të garantuar mbështetje për aktivitetet që ndodhin në periudha të ndryshme.
4. Ndarja e mjeteve realizohet në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e financave publike dhe rregullat e menaxhimit financiar.

Neni 7 **Mënyra e realizimit të subvencionimit**

1. Subvencionimi sipas kësaj Rregulloreje realizohet përmes rimbursimit të shpenzimeve të realizuara nga përfituesi;
2. Rimbursimi i shpenzimeve realizohet pas dorëzimit të dokumentacionit financiar dhe fiskal përkatës, përfshirë faturat, dëshmitë e pagesës, biletat, konfirmimet e pjesëmarrjes dhe dokumentet tjera mbështetëse të përcaktuara në formularin përkatës.
3. Për aktivitetet që kërkojnë pagesë paraprake, IPK mund ta aprovojë kërkesën për paradhënie në përputhje me diispozitat e kësaj Rregulloreje.

KAPITULLI III **KRITERET DHE PËRFITUESIT**

Neni 8 **Kriteret e përgjithshme**

1. Përfitues i subvencionit është punonjësi i IPK-së i cili:
 - 1.1. Është në marrëdhënie të rregullt pune në IPK;

- 1.2. Realizon aktivitete që lidhen me planin e punës dhe fushëveprimtarinë e IPK-së;
- 1.3. Posedon ftesë, konfirmim ose dëshmi për publikim apo prezantim;
- 1.4. Nuk ka obligime të papërfunduara ndaj IPK-së nga subvencionet paraprake;
- 1.5. Projekti apo aktiviteti për të cilin kërkohet subvencionimi nuk duhet të jetë i financuar paraprakisht nga burime tjera institucionale për të njëjtin qëllim.
- 1.6. Respekton standardet e etikës dhe integritetin akademik.

Neni 9

Kriteret specifike për publikime shkencore

1. Për subvencionimin e publikimeve shkencore, aplikuesi duhet të paraqesë:
 - 1.1. Artikullin shkencor dhe dëshminë për pranimin e tij;
 - 1.2. Të dhënat për revistën shkencore ose shtëpinë botuese shkencore;
 - 1.3. Dëshminë për tarifën e publikimit;
 - 1.4. Arsyetimin për rëndësinë akademike të publikimit.
2. Prioritet kanë publikimet në revista të indeksuara me impakt factor dhe me proces recensimi shkencor.

Neni 10

Kriteret për konferenca shkencore

1. Për subvencionimin e pjesëmarrjes në konferenca shkencore, aplikuesi duhet të paraqesë:
 - 1.1. Ftesën ose konfirmimin për pjesëmarrje;
 - 1.2. Abstraktin ose punimin shkencor të pranuar;
 - 1.3. Programin dhe agjendën e konferencës;
 - 1.4. Dëshminë për përlogaritjen e shpenzimeve për tarifën e pjesëmarrjes dhe publikimit;

1.5. Arsyetimin dhe relevancën për avancimin e punonjësve dhe performancën e Institutit.

2. Prioritet kanë konferencat ndërkombëtare dhe ato të organizuara nga institucione të njohura akademike.

Neni 11

Kriteret për projekte shkencore

1. Për subvencionimin e projekteve shkencore, aplikuesi duhet të paraqesë:
 - 1.1. Përshkrimin dhe arsyeshmërinë e projektit;
 - 1.2. Rëndësinë dhe ndërlidhjen me prioritetet dhe fushëveprimin e IPK-së;
 - 1.3. Inovacionin, relevancën shkencore të projektit dhe interesin e përgjithshëm për kërkim në këtë fushë;
 - 1.4. Ndërlidhjen me fushat prioritare të Programit Kombëtar të Shkencës;
2. Projektet shkencore duhet të jenë të aprovuara nga Këshilli Shkencor i IPK-së sipas procedurave të brendshme në fuqi.
3. Projektet shkencore duhet të jenë me interes të veçant për avancimin e veprimtrarisë shkencore të Institutit.

KAPITULLI IV

PROCEDURA E APLIKIMIT DHE VLERËSIMIT

Neni 12

Thirrja për aplikim

1. IPK mund të shpallë thirrjen e brendshme ose të pranojë aplikime gjatë tërë vitit, në varësi të planifikimit buxhetor.
2. Thirrja përmban:
 - 2.1. Kriteret për kategorinë e subvencionimit;
 - 2.2. Dokumentacionin e nevojshëm sipas kësaj Rregullore;
 - 2.3. Afatet e aplikimit;
 - 2.4. Mënyrën e dorëzimit të aplikimit;

3. Thirrja për aplikim publikohet në ueb faqen zyrtare të IPK-së dhe përmës komunikimit të brendshëm institucional.

Neni 13

Dokumentacioni për aplikim

1. Aplikuesi duhet të dorëzojë:
 - 1.1. Kërkesën për subvencionim;
 - 1.2. Formularin e aplikimit;
 - 1.3. Dokumentet mbështetëse sipas llojit të aktivitetit;
 - 1.4. Deklaratën për saktësinë e të dhënave;
2. Dokumentacioni mund të dorëzohet në formatin fizik apo elektronik;
3. Dokumentacioni i pakompletuar ose i dorëzuar jashtë afateve të përcaktuara nuk merret në shqyrtim.

Neni 14

Komisioni për vlerësim

1. Këshilli Shkencor i IPK-së cakton Komisionin për vlerësimin e aplikimeve;
2. Komisioni përbëhet nga tre (3) anëtarë, nga të cilët:
 - 2.1. Një anëtar nga Departamenti për shërbime të përgjithshme që njëherit është edhe Kryesues i komisionit;
 - 2.2. Një anëtar nga Departamenti kërkimor-shkencor;
 - 2.3. Një anëtar nga Departamenti për mbështetje profesionale-pedagogjike;
3. Komisioni ka këto detyra dhe kompetenca;
 - 3.1. Shqyrton aplikimet dhe dokumentacionin përcjellës;
 - 3.2. Vlerëson përmbushjen e kriterëve;
 - 3.3. Harton raportin e vlerësimit të aplikimeve;
 - 3.4. Rekomandon për përfituesit dhe shumën e subvencionit për secilin aplikues;

4. Komisioni duhet të shqyrtojë aplikimin brenda 30 ditëve të punës nga mbyllja e thirrjes ose dorëzimi i aplikimit.
5. Anëtar i Komisionit nuk mund të vlerësojë aplikimin e tij ose të një personi me të cilin ka bashkautorësi në punimin që kërkohet të subvencionohet.
6. Në rastin si në pikën 5 të këtij Neni, drejtori i Institutit, me vendim të veçantë, e zëvendëson anëtarin përkatës.
7. Anëtarët e Komisionit janë të obliguar të shmangin konfliktin e mundshëm të interesit dhe të deklarojnë me shkrim çdo lidhje me aplikuesin.
8. Mandati i Komisionit është dy vite, me mundësi vazhdimi vetëm edhe për një mandat tjetër.
9. Për kompensimin e anëtarëve të Komisionit vlerësues, zbatohen dispozitat e Legjislacionit në fuqi.

Neni 15 **Vendimmarrja**

1. Vendimi për ndarjen e subvencioneve merret nga drejtori i IPK-së, bazuar në rekomandimin e Komisionit vlerësues.
2. Vendimi përmban:
 - 2.1. Emrin dhe mbiemrin e përfituesit;
 - 2.2. Llojin dhe aktivitetin e subvencionit;
 - 2.3. Shumën e aprovuar të subvencionit;
 - 2.4. Planin dhe afatin e realizimit të subvencionit.
3. Të drejtat dhe obligimet ndërmjetë IPK-së dhe përfituesit të subvencionit rregullohet me kontratë të veçantë, varësisht nga lloji dhe natyra e subvencionimit.
4. Rezultatet e vendimmarrjes publikohen në ueb faqen e IPK-së brenda shtatë (7) ditëve nga marrja e vendimit përfundimtar;
5. Kandidatët e pakënaqur me vendimin e Komisionit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në Këshillin Drejtues të IPK-së brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimi të vendimit;
6. Ankesa paraqitet në formë të shkruar dhe duhet të jetë e arsyetuar, duke specifikuar faktet, rrethanat dhe bazën juridike të kundërshtimit të vendimit;

7. Këshilli Drejtues i IPK vendos për ankesën brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga pranimi të ankesës.
8. Vendimi ndaj ankesës i Këshillit Drejtues është përfundimtar në procedurën e brendshme administrative.

KAPITULLI V

LIMITET FINANCIARE DHE SHUMAT MAKSIMALE TË SUBVENCIONIMIT

Neni 16

Shumat financiare për publikime shkencore

1. Subvencionimi i tarifave për publikimin e një punimi shkencor në revista me faktor ndikimi (Impact Factor) apo të indeksuara në platformat Scopus dhe Web of Science, mbulohet në shumën maksimale si më poshtë:
 - 1.1. Revistat e ranguar në Q1 dhe Q2 mbulohen 100%, por jo më shumë se 2,500.00 €;
 - 1.2. Revistat e ranguar në Q3 dhe Q4 mbulohen 80% por jo më shumë se 1,500.00 €;
2. Nuk do të subvencionohen publikimet në revista që konsiderohen si 'grabitqare' (predatory journals) sipas listave ndërkombëtare të njohura (p.sh. Beall's List).
3. Për publikime në revista të tjera shkencore ndërkombëtare, shuma maksimale është 80%, por jo më shumë se 1,000.00 €;
4. Komisioni vlerësues rezervon të drejtën e verifikimit të indeksimit të revistës dhe përputhshmërisë së saj me standardet ndërkombëtare shkencore.

Neni 17

Shuma financiare për pjesëmarrje në konferenca shkencore ndërkombëtare

Për pjesëmarrje dhe prezantim në konferenca shkencore ndërkombëtare, shuma e subvencionimit është deri në vlerën maksimale prej 800.00€ për konferenca në rajon dhe 1,500.00€ për konferenca jashtë rajonit.

Neni 18
Projekte e veçanta dhe librat shkencorë

1. Për realizimin dhe botimin e punimeve nga projektet e veçanta hulumtuese dhe shkencore, që e kanë kaluar procesin e recensionit nga komisioni i IPK-së, shuma maksimale për mbulimin e shpenzimeve është deri në 8 000.00€.
2. Subvencionimi për një kapitull libri në botime prestigjioze ndërkombëtare, me faktor ndikimi (Impact Factor) apo të indeksuara në platformat Scopus dhe Web of Science, shuma maksimale është 100%, por jo më shumë se 1,000.00 €.

Neni 19
Kufizimet vjetore për aplikuesit

1. Një punonjës i IPK-së nuk mund të përfitojë më shumë se dy (2) subvencione brenda një viti fiskal, pavarësisht kategorisë së aplikimit;
2. Në rastet e bashkautorësisë mes punonjësve të IPK-së, shuma e subvencionit mbulohet vetëm një herë për atë punim;

Neni 20
Rishikimi i shumave

Shumat financiare dhe kufizimet vjetore të përcaktuara në këtë kapitull mund të rishikohen nga menaxhmenti i IPK-së dhe me aprovim nga Këshilli Drejtues, varësisht nga planifikimi buxhetor dhe ndarjet e mjeteve nga MASH për vitin përkatës fiskal.

KAPITULLI VI
OBLIGIMET E PËRFITUESVE

Neni 21
Obligimet kontraktuale të përfituesit

1. Përfituesi i subvencionit obligohet që:
 - 1.1. Të përfaqësojë IPK-në në mënyrë profesionale dhe etike;
 - 1.2. Ti përdorë mjetet vetëm për qëllimin e aprovuar;

- 1.3. Të paraqesë raport narrativ dhe financiar pas realizimit të aktivitetit;
- 1.4. Të dorëzojë dëshmi origjinale për shpenzimet e realizuara, përfshirë kostot e publikimit, pjesëmarrjes, transportit dhe akomodimit;
- 1.5. Të dorëzojë një deklaratë nën betim (sipas formularit përkatës) që vërteton se aktiviteti/artikulli nuk është financuar nga burime të tjera;
- 1.6. Në çdo publikim ose prezantim të subvencionuar, përfituesi është i obliguar të specifikojë përkatësinë institucionale të Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK).

Neni 22

Raporti përfundimtar i përfituesve

1. Përfituesi është i obliguar të dorëzojë raportin përfundimtar brenda tridhjetë (30) ditëve pas realizimit të aktivitetit.
2. Raporti duhet të përmbajë:
 - 2.1. Përshkrimin e aktivitetit dhe rezultatet e arritura;
 - 2.2. Dëshmitë për pjesëmarrje, publikim, apo realizim të konferencës (edhe për ato online);
 - 2.3. Raportin financiar të detajuar dhe të aprovuar nga drejtori i IPK-së, për realizimin e projekteve të veçanta hulumtuese dhe librat shkencorë;
 - 2.4. Dëshmi specifike për koston e realizimit të secilës pikë të kërkesës (fatura të rregullta, konfirmime pagese, etj.).
3. Raporti përfundimtar përgatitet sipas formularit të veçantë për secilën nga kategoritë e subvencionimit me këtë Rregullore.

Neni 23

Kthimi i mjeteve

1. Përfituesit e projekteve të veçanta hulumtuese dhe libra shkencorë obligohen t'i kthejnë mjetet e pranuar në këto raste:
 - 1.1. Mjetet janë përdorur në kundërshtim me këtë Rregullore;
 - 1.2. Aktiviteti nuk është realizuar ose mungon dëshmia për koston dhe realizimin;

1.3. Janë paraqitur të dhëna të pasakta apo deklarime jo të vërteta mbi financimin e dyfishtë;

1.4. Kosto e realizimit të projektit është më e ulët se kosto e subvencionit të fituar.

1.5. Punimi i prezantuar/publikuar rezulon të jetë plagjiaturë.

1.6. Në rast se vërtetohet shkelje e rëndë e etikës ose plagjiaturë, përfituesi humb të drejtën e aplikimit për subvencionim nga IPK për 3 vitet e ardhshme.

KAPITULLI VII TRANSPARENCA DHE MBIKËQYRJA

Neni 24

Transparenca dhe llogaridhënia

1. IPK siguron transparencë në procesin e ndarjes së subvencioneve përmes publikimit të të dhënave sipas legjislacionit në fuqi.
2. Lista për përfituesit e subvencioneve të aprovuara publikohet në faqen zyrtare të IPK-së.
3. Ndarja e subvencionit për publikime shkencore merr për bazë nevojat e zhvillimit akademik të stafit, duke u dhënë prioritet kërkesave mininale për avancim në thirrjen akademike/shkencore të punonjësit.

Neni 25

Mbikëqyrja dhe raportimi

1. Zbatimi i kësaj Rregulloreje mbikëqyret nga Drejtori dhe Këshilli Drejtues i IPK-së;
2. Organet mbikqyrëse kanë të drejtë të kërkojnë dokumente shtesë dhe të kryejë verifikime lidhur me përdorimin e mjeteve.
3. Organet mbikëqyrëse verifikojnë që kufizimi i numrit të aplikimeve dhe kategorive përfituese brenda një viti kalendarik të jenë në përputhje me limitet e përcaktuara në këtë Rregullore.
4. Drejtori i IPK-së, në kuadër të raportit vjetor financiar, përfshinë edhe kategorinë ekonomike “Subvencione dhe transfere”.

KAPITULLI VIII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 26 Formularët

Formularët për aplikim dhe raportim, sipas kategorive specifike, janë pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 27 Çështjet e parregulluara


Për çështjet që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi.

Neni 28 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës.

Kryesues i Këshillit Drejtues të IPK-së

**U.d. i Drejtorit
Dr. sc. Murteza Qsdautaj**



Aplikimi Numër: ____

Viti: 2026

Formulari i Aplikimit për Subvencion për publikime shkencore

Të dhënat e përgjithshme

Të dhënat personale të aplikuesit	
Emri dhe mbiemri	
Titulli / Thirrja shkencore	
Data e marrjes së thirrjes më të lartë	
E-mail	
Numri i telefonit	
Kodi postar / Qyteti	
Gjinia	
Grada / Thirrja më e lartë shkencore (ju lutem zgjidhni vetëm një)	☐ Këshilltar shkencor; ☐ Bashkëpunëtor i lartë shkencor; ☐ Bashkëpunëtor shkencor; ☐ Hulumtues i pavarur; ☐ Hulumtues; ☐ Tjetër (specifiko)

Departamenti i aplikuesit	
Departamenti	
Shefi i departamentit (emri, mbiemri dhe e-mail adresa)	
Divizioni	
Shefi i divizionit (emri, mbiemri dhe e-mail adresa)	

Publikimi shkencor: Të deklarohen të dhënat për publikimin shkencor të realizuar.

Shtëpia botuese dhe revista shkencore	
Botuesi (emri dhe linku)	Inderscience ...
Revista shkencore (emri dhe linku)	International Journal of ...
Titulli i publikimit të botuar	
Të dhënat për autorin/ët	
Linku ... numri ... vëllimi ...	

Të dhëna tjera (shëno Q1-Q4)	
Shuma e shpenzuar për publikimin shkencor (bashkangjit dëshmitë)	

Konferenca shkencor: Të deklarohen të dhënat për konferencën shkencor, publikimin dhe prezantimin e realizuar në konferencë.

Konferenca shkencore	
Koferenca shkencore (linku)	
Titulli dhe abstrakti punimi	
Dëshmi për pranim të Abstraktit	
Programi dhe agjenda e konferencës	
Publikimi i punimeve të konferencës – nëse ka (Conference proceedings)	
Shuma e shpenzuar për realizimin e konferencës	

shkencore (bashkangjit dëshmitë)	
--	--

Projekti shkencor: Të deklarohen të dhënat për projektin shkencor të planifikuar ose në proces të realizimit.

Projekti shkencor	
Titulli i projekti shkencor	
Bartësi dhe anëtarët në projekt	
Periudha e hulumimit dhe realizimit (6-12 muaj)	
Dëshmia e aprovimit nga Këshilli Shkencor	
Raport për projektin në proces dhe progresin deri në këtë fazë	
Plani financiar për realizimin e projektit shkencor	


Të dhënat bankare të aplikuesit

Emri i bankës	
Emri i llogarisë	
Numri i llogarisë	
Kodi Sort	
Numri IBAN	
SWIFT / BIC	

IBAN zëvendëson numrin e llogarisë dhe kodin sort. Financimi do të bëhet në euro.

Plani financiar për realizimin e projektit shkencor

Plani i përgjithshëm buxhetor	
Kosto totale të parashikuara (Euro)	
Bashkëfinancimi (nëse është e aplikueshme) - Shuma e mbuluar nga pala/palët e treta	
Emri dhe adresa e institucioneve ose donatorëve bashkë-financuese	
Fondet në dispozicion (nëse është e aplikueshme) – Burimet vetanake <i>Çfarë mund të kontribuoni në implementimin e projektit të planifikuar, si shtesë ndaj fondeve të kërkuara.</i>	
Personeli / Stafi	
Buxheti për paisje, shpenzime të udhëtimit etj.	
Infrastruktura	
Shuma totale e kërkuar	
Mbështetje tjetër financiare <i>A keni pranuar ose kërkuar tjetër mbështetje rreth projektit tuaj? A planifikoni të aplikoni për fonde shtesë? Nëse po, nga cili institucion / fondacion dhe bazuar në cilën thirrje? Në rast të fondeve të pranuar paraqitni konfirmimin e institucionit që ju ka mbështetur.</i>	



Plani i detajuar buxhetor

Kostot e personelit

Në çdo rast tregoni: emrin, natyrën e kontratës, periudhën e përfshirjes në projekt në formën e muajve për person (përqindja e kohës së plotë në orë / ditë / muaj) koston bruto mujore ose pagesën ditore (në euro) si dhe koston totale.

Emri dhe natyra e aktivitetit	Koha e shpenzuar në projekt (ekuivalenti përkundrejt kohës së plotë)	Kostoja bruto në euro (mujore ose e përditshme)	Kostot totale në euro

Shënim me rëndësi: Nuk lejohet financimi prej këtij projekti i personelit të IPK-së që paguhen nga burime të tjera financiare **(nuk lejohet financimi i dyfishtë)**. Për shembull, nuk pranohet që të përlllogariten kosto shtesë për personelin e IPK-së që është punësuar me orar të plotë.

Shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit jashtë shtetit¹ (nëse është e aplikueshme)

	6 Mujori i parë	6 Mujori i dytë	Kostoja totale në euro
Kostot e udhëtimit			
Akomodimi			
Ushqimi			
Totali			

Kostoja totale dhe shuma e kërkuar

Përmbledhja në euro	6 Mujori i parë	6 Mujori i dytë	Totali
Kostot e personelit			
Udhëtimi dhe qëndrimi jashtë vendit			

¹ Shpenzimet e bëra gjatë udhëtimeve duhet të justifikohen. Llogarisni përafërsisht numrin e udhëtimeve ndërkombëtare.

Paisje specifike (të specifikohet)			
Kostot e ekspertizës së jashtme dhe konsulencës			

Kosto të tjera (të specifikohen)			
Kostot totale			
Shuma totale e kërkuar (duke përfshirur bashkëfinancimin dhe shumën e mbuluar nga burimet vetanake)			

Deklaratë e aplikuesit

Unë deklaroj se për realizimin e këtij projekti nuk kam kërkuar dhe nuk kam mbështetje financiare nga organizata apo institucione tjera.

Unë do të informojë IPK-në, nëse kërkoj mbështetje për këtë projekt nga organizata të tjera, apo nëse më ofrohet mbështetja shtesë gjatë realizimit.

Nëpërmjet nënshkrimit tim unë vërtetoj se informacioni i dhënë këtu është i saktë dhe i plotë.

IPK ka të drejtë të përpunojë me kompjuter të gjitha të dhënat që lidhen me aplikimin, të publikojë pjesë të tyre në raportet vjetore apo tu`a kalojë ato palëve të treta në formë anonime për qëllime statistikore apo qëllime që lidhen me politikat shkencore.

Unë i/e nënshkruari/a, deklaroj se të gjitha shpenzimet e kërkuara nga ky aplikim do të përdoren vetëm për realizimin e këtij projekti sipas planit përkatës financiar.

Nënshkrimi i bartësit/es së projektit

Vendi, data

Deklaratë e anëtarit të angazhuar në projekt (Anëtari 1)

Unë _____, me anë të kësaj deklaratë konfirmoj pjesëmarrjen në projektin hulumtues me titull “ _____ ” në cilësinë e anëtarit të projektit me të gjitha kapacitetet dhe njohuritë profesionale të cilat i posedoj.

Si i punësuar në _____ pranë (institucioni) “ _____ ” do të jap kontributin tim të drejtëpërdrejtë në realizimin e punimeve të hulumtimit dhe procesin e mbarëvajtjes së tij.

Me respekt!

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi

Prishtinë, _____

Data:

Deklaratë e ekspertit të jashtëm të angazhuar në projekt

Unë _____, me anë të kësaj deklarate konfirmoj pjesëmarrjen në projektin hulumtues me titull " _____ " në cilësinë e ekspertit të jashtëm të projektit.

Si ekspert i jashtëm, jam i gatshëm të jap kontributin tim që projekti të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Me respekt!

Emri dhe mbiemri

Nënshkrimi

Prishtinë, _____

Data